



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË
TIRANË

Nr.rregj.them. 141

Dt.23/08/2021.

LENDË: Njoftim I séances per sigurimin e padise (*bashklidhur kerkesa per sigurimin e padise dhe provat*).

DREJTUAR: Bashkia Shkoder.

me adrese; Shkoder.



Prane Gjykes Administrative te Shkalles se Pare, Tirane eshte paraqitur per gjykim ceshtja me nr.rregj.them. 141 dt. 23/08/2021, qe I perket paleve ndergjyqese:

Kerkuese: Almiro Gurakuqi.

Personi i trete: 1. Komisioni I Prokurimit Publik. 2. Bashkia Shkoder.

Objekti: Marrja e mases se sigurimit te padise duke pezulluar zbatimin e vendimit nr. 498/2021 te Komisionit te Prokurimit Publik dt. 18/08/2021.

Baza Ligjore: Neni 28, 29, 30 e vijues te Ligjit nr. 49/2012 "Per gjykatat administrative dhe Gjykimin e mosmarreshjeve administrative", i ndryshuar. K. Pr. Administrative I RSH, miratuar me ligjin nr. 44/2015.

Seanca per marrjen e sigurimit te padise caktohet me dt. 26.08.2021 ora 09:00.

Ju bejme se dije se mosparaqitja juaj shkakton gjykim ne mungese dhe mosparaqitja e provave para seances gjyqesore shkakton mospranimin e tyre.

Gjyqtari
Gentiana Mucaj



KËRKESË

(Për Marrjen e Masës së sigurimit të Padisë)

Tiranë, më 20.04.2021

Kërkues: ALMIRO GURAKUQI, P.F nr. NIPTI K31823027R &
CARPATHIA ALBANIA shpk nr.NIPTI L41629009A, përfaqësuar
me prokurë nga Almiro Gurakuqi, me adresë Rr. "Muhamet Gjollështa",
Paallati 9 katësh Nr.2/2, Tiranë.

Person i Tretë: 1. Komisioni I Prokurimit Publik me adresë, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Pallati I Kongreseve, Kati 1.

2. Bashkia Shkodër, me adresë Rr. "13 Dhjetori", Shkodër.

Objekti: Marrjen e Masës së Sigurimit të Padisë duke pezulluar zbatimin e vendimit Nr.
498/2021 te Komisionit te Prokurimit Publik date 18/08/2021

B.ligjore: Neni 28, 29, 30 e vijues të Ligjit nr. 49/2012 "*Përgjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*", I ndryshuar, "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*", miratuar me Ligjin nr. 44/2015.

Drejtuar: GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË TIRANË



E nderuar Gjykatë,

Rrethanat e Faktit

Me date 11.05.2021 eshte zhvilluar procedura e ankandit nga autoriteti Bashkia Shkoder me objekt "Shitje me ankand te aksioneve te Klubit te futbollit "Vllaznia"sha ne masen 100%" dhe me vlere fillestare 50,794,000 (pesedhjetë milion e shtatëqind e nentëdhjetë e kater mijë) leke.

Me daten e mbajtjes se ankandit oferta jone u dorezua si BOE Almir Gurakuqi PF & Carpathia Albania ne vleren totale 55,000,000 leke me TVSH vlere e cila u reflektua dhe nga njesia e ankandit ne proces verbalin nr.7369 prot date 11.05.2021.

Referuar njoftimit nr.7757 prot date 11.05.2021 u vume ne dijeni se oferta jone eshte skualifikuar dhe brenda afateve ligjore, jemi ankuar tek Autoriteti Shites Bashkia Shkoder, me daten 24.05.2021, ku kemi paraqitur ankese duke dorezuar formularin perkates te ankeses, prane autoritetit shites, Bashkia Shkoder, protokolluar me nr. 7936 prot., date 24.05.2021

Bashkimi i Operatoreve ALMIRO GURAKUQI, P.F nr. NIPTI K31823027R & CARPATHIA ALBANIA shpk nr.NIPTI L41629009A me date 02/06/82021 kane ushtruar Ankim prane Komisionit te Prokurimit Publik ndaj Vendimit te autoritetit Shites Bashkia Shkoder per ankandit publik "Procedurë e hapur", me objekt "Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" Sh.A, në masën 100%.", me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër.

Ndaj ketij Ankimi, Komisioni I Prokurimit Publik ka Vendosur:

- 1- Të mos pranohet ankese e paraqitur nga bashkimi i kandidatëve blerës "Almiro Gurakuqi" P.F& "Carpathia Albania" ShPK , për procedurën e ankandit "Procedurë e hapur", me objekt "Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" Sh.A, në masën 100%.", me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër.
- 2- Autoriteti shitës lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
- 3- Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
- 4- Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Komisioni ka keqinterpretuar Ankimin tone duke mos iu permbajtur objektit te ankese, pasi ne ankim nuk kemi kerkuar kualifikimin e tone si Bashkim Operatoresh por shfuqizimin e vendimit të autoritetit shitës mbi skualifikimin e bashkimit të kandidatëve blerës "Almiro Gurakuqi" P.F & "Carpathia Albania" ShPK nga procedura e ankandit publik "Procedurë e hapur", me objekt "Bashkia Shkodër shet me procedurë ankandi aksionet e Klubit të Futbollit "VLLAZNIA" Sh.A, në masën 100%.", me vlerë fillestare 50,794,000 (pesëdhjetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.03.2021, nga autoriteti shitës Bashkia Shkodër dhe anulimi i procedurës së ankandit publik të sipërcituar.

Objekti i Ankimit tone prane Komisionit te Prokurimit Publik ka qene argumentuar dhe i provuar pasi edhe Autoriteti I Konkurences ne Vendimet e veta (ku janë dy vendime), **Vendimi Nr.780 I datës 04.03.2021 dhe Vendimi Nr.105/10 Prot, të datës 15.06.2021**, ka konstatuar se jane shkelur

të drejtat për një pjesëmarrje të barabartë në procedurën e ankandit të zhvilluar, ku operatori I vetëm që është shpallur I kualifikuar në fazën e fundit të procedurës, është favorizuar vazhdimisht që nga hapja e procedurës.

Cështjet Ligjore dhe Arsyetimi i Paditësit

E nderuar Gjykatë,

Siç e kemi referuar mësipër, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon se të drejtat dhe liritë e njeriut, pluralizmi, janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë ato.

Këtë akt administrativ ne e konsiderojmë të marrë pa prova, me qëndrime të njëanshme dhe të paligjshme nga pala e paditur, në kundërshtim, në lajthitje, si dhe në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik.

Fillimisht, bazuar në nenet 28, 29 e vijues të Ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, duke marrë në konsideratë natyrën e çështjes objekt gjykimi – ankesë ndaj vendimit të Komisionit Te Prokurimit Publik,



Kërkesa jonë për marrjen e masës së sigurisë bazohet në nenin 28 e vijues të Ligjit nr. 49/2012, pasi gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston rreziku real dhe mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm.

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë duhet të vlerësojë pikërisht këtë fakt, pra dëmin që do të shkaktojë jo vetëm ne si palë paditëse por të gjithë Komunitetit she shoqërisë së Shkodrës. Ky dëm provohet me të gjitha provat shkresore të depozituara në gjykatë.

Në këtë këndvështrim, në kuptim të ligjit dhe të interpretimit të zgjeruar që bën Vendimi Unifikues nr. 10 datë 24.03.2004 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku thuhet se “nëpërmjet masës së sigurimit të padisë synohet kryesisht që të mbahet e ngrirë gjendja faktike e mosmarrëveshjes, derisa gjykata të zgjidhë përfundimisht çështjen në themel.”

Është pikërisht ajo që ne kërkojmë të arrijmë me anë të kësaj masë sigurimi, pra mbajtjen të ngrirë të gjendjes faktike të mosmarrëveshjes. Me marrjen e masës së sigurimit të padisë në këtë rast, do të realizohet mbajtja e ngrirë e zbatimit të vendimit të paligjshëm të Komisionit të Prokurimit Publik.

Në referencë dhe në interpretim të dispozitave të mësipërme, në gjykime të këtij lloji, në mënyrë që gjykata të vendosë për marrjen e një mase sigurimi padie (të parashikuara këto të fundit në nenin 206 të K.Pr.Civile), duhet të paraqitet e provuar me prova shkresore ekzistenca e dy kushteve themelore:

a- Ekzistenca e mundshme e një të drejtë për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjyqësorisë;

E drejta jonë është e provueshme pasi disponohet i gjithë dokumentacioni shkresor, në përputhje me ligjin, i cili vërteton se ne kërkuesit jemi pjesëmarrës në ankandin public të zhvilluar nga Bashkia Shkodër dhe që kemi ndjekur të gjithë hapat që parashikon ligji për ta kërkuar të drejtën që na është mohuar në rrugë administrative hallkë pas hallke duke respektuar procedurën dhe hierarkinë e organeve. Në këto kushte nuk ka asnjë dyshim mbi të drejtën tonë të cilën pretendojmë ta sigurojmë nëpërmjet kësaj kërkesë.

Në këto kushte jemi të detyruar që të kërkojmë marrjen e masës së sigurimit të padisë për faktin se ekziston si e drejta për të cilën ne kërkojmë mbrojtje nga procesi gjyqësor, ashtu edhe për faktin se ekzistojnë të gjitha kushtet që ekzekutimi i vendimit të dhënë nga gjykata të jetë tejet i pamundur në të ardhmen duke na sjellë pasoja shumë të rënda dhe të pariparueshme.



b- Ekzistenca e frikës që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Sipas nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, masa e sigurimit të padisë duhet marrë kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë.

Ligjvënësi ka parashikuar sigurimin e padisë jo vetëm për të siguruar të drejtën, e cila përbën dhe tërësinë e kërkimeve të paditësit, por në të njëjtën kohë këtë parashikim e ka bërë dhe me qëllimin që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor që është duke u realizuar mes palëve.

A ekziston një e drejtë për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë?

Ne çmojmë se në respektim të Nenit 29, shkronja “a” të Ligjit 49/2012, por edhe të Nenit 202, shkronja “a” të Kodit të Procedurës Civile tërësia e provave shkresore që paraqesim në këtë fazë, dhe të cilat më vonë në afatin procedural të përcaktuar në ligj do t’i nënshtrohen hetimit dhe debatit gjyqësor dhe që shoqërojnë këtë kërkim, janë të mjaftueshme për gjykatën që të marrë masë të shpejtë për sigurimin e padisë.

Kërkesa jonë mbi të gjitha bazohet në natyrën që ka objekti ynë I ankimit, pasi nëse do të tjetërsohej pronësia e aksioneve duke kaluar nga Bashkia Shkodër tek Operatori ekonomik që është shpallur I kualifikuar (fitues), Klubi I Futbollit Vllaznia mund të pësojë dëme të pa riparueshme, pasi Operatorit I lindin të gjitha të drejtat që të menaxhojë në mënyrën që do jo vetëm asetet e Klubit por edhe grupin e lojtarëve, stafin teknik dhe gjithë personelin.

Duke qënë se në gjëndjen që është Klubi I futbollit është garues dhe pretendent në garat sportive në gjëndjen në të cilën ndodhet, një keqmenaxhim do të çonte në shkatërrimin e tij.

Gjithashtu, operatorit do ti lindte e drejta e tjetërsimit të aseteve të klubit të futbollit dhe kjo sërish do të ishte një humbje e pa riparueshme më pas.

A ekziston frikë që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë?

Masa e sigurimit të padisë që kërkojmë të merret nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë është e përshtatshme dhe e dobishme për të mbrojtur pikërisht të drejtat e pretenduara të Paditësit. Kjo masë që kërkojmë të merret është në respektim të nenit 30 të Ligjit 49/2012 dhe të Nenit 206 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.10, datë 24.03.2004, ku shprehimisht parashikohet se: “*gjykata rast pas rasti ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të dobishme dhe të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të të paditurit*”.

Masa e sigurimit që kërkojmë të vendoset është një masë që duhet të merret me qëllimin e vetëm që të mundësohet mbajtja e një gjendje juridike dhe faktike konstante, e cila mundëson që të drejtat potenciale të paditësit të mbrohen nga bërja e vështirë e ekzekutimit të vendimit, pra që asetet e Klubit të Futbollit Vllazni (dhe me asete nënkuptojmë jo vetëm ato objekte dhe të drejta që janë në pronësinë e Klubit por edhe burimet njerëzore, lojtarë, stafi teknik etj.).

Ky konkluzion vjen në harmoni dhe në përputhje me vendimin nr.10, datë 24.3.2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku shprehimisht thuhet: “Marrja e masave të përkohëshme të sigurimit të padisë synon “*ta mbajë gjëndjen ashtu siç është*”, apo “*të ngrirë*”, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila, për vetë natyrën e çështjes, duhet të realizohet nëpërmjet një

procedurë të shpejtë dhe relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur, gjithësesi, që të respektohet një standart i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor”.

Gjithashtu, referuar përcaktimit të Nenit 29, pika b të Ligjit nr 49/2012, sqarojmë se pezullimi i kësaj procedure nuk mund të çënojë në asnjë rast interesin publik, përkundrazi është totalisht në përmbushje të interesit publik dhe kushtetues.

Sa më sipër, i drejtohem Gjykatës brenda afateve ligjore, dhe përfundimisht kërkojmë:

Marrjen e Masës së Sigurimit të Padisë sipas objektit të Kërkesës.

KËRKUESI

Almiro Gurakuqi

